


PERCEPTIMET PUBLIKE PËR BESIMIN, KORRUPSIONIN DHE INTEGRITETIN E INSTITUCIONEVE PUBLIKE NË KOSOVË



Interpretimi i të dhënave

Plator Avdiu

Rishikimi i brendshëm:

Shpat Balaj

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë nga anketa e Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP). BSBP është një nismë e re rajonale e iniciuar nga QKSS në vitin 2020, e cila zbatohet në bashkëpunim me Qendrën e Beogradit për Politikën e Sigurisë (BCSP) në Serbi dhe Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) në Shqipëri, me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED). BSBP shërben si një instrument për të matur perceptimet e publikut në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi për çështje të ndryshme lidhur me sigurinë. Të dhënat tregojnë se si qytetarët i perceptojnë apo informohen rreth çështjeve të paraqitura në këtë raport. Si të tilla, pikëpamjet e paraqitura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e QKSS, BCSP, CSDG ose NED.

Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën Angleze.

Financohet nga :



Konsorciumi i drejtuar nga:



PERCEPTIMET PUBLIKE PËR BESIMIN, KORRUPSIONIN DHE INTEGRITETIN E INSTITUCIONEVE PUBLIKE NË KOSOVË

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje ekzekutive.....	1
Hyrje	2
Metodologjia	2
1. Besimi i publikut në institucionet shtetërore dhe joshtetërore të Kosovës ...	4
1.1. Besimi në institucionet shtetërore	4
1.2. Besimi në institucionet joshtetërore	8
2. Perceptimet e të anketuarve për korrupsionin në Kosovë.....	10
3. Integriteti i procesit të rekrutimit në administratën publike të Kosovës ...	14
Referencat	16

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Institucionet e sigurisë në Kosovë vazhdojnë ta ruajnë, e në disa raste madje po e rrisin besueshmërinë e tyre tek qytetarët, duke rezultuar si institucionet më të besueshme në krahasim me sektorët e tjerë. Forca e Sigurisë së Kosovës është institucioni më i besueshëm nga 83 për qind e të anketuarve, e ndjekur nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave me 73 për qind dhe Policia e Kosovës, të cilës i besojnë 72 për qind e të anketuarve. Ndërsa, dy institucione të tjera të sigurisë kanë shënuar rritje domethënëse në vitin 2022: rreth 60 për qind e të anketuarve kanë besim në Inspektoratin Policor të Kosovës dhe 51 për qind në Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë. Kjo është hera e parë që të dy institucionet gëzojnë besueshmëri prej më shumë se 50 për qind e të anketuarve. Presidentja e Kosovës me 59 për qind dhe komunat me 55 për qind janë renditur si më të besueshmet sa i përket institucioneve qendrore dhe lokale, të pasuara nga Dogana e Kosovës me 46 për qind.

Përkundrazi, trendi i besimit në institucionet e sektorit të drejtësisë – Gjykatat dhe Prokuroria – është mjaft negativ dhe ka mbetur i pandryshuar në krahasim me vitet e mëparshme. Në vitin 2022, vetëm 30 për qind e qytetarëve deklaruan se kishin besim në këto dy institucione. Institucioni më pak i besueshëm nga lista e institucioneve shtetërore është Kuvendi i Kosovës me 25 për qind, i ndjekur nga Qeveria e Kosovës me 33 për qind besueshmëri. Të dy këto institucione qendrore kanë shënuar rënie të besueshmërisë në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021. Sa i përket institucioneve jashtetërore të Kosovës, më të besueshmit janë bashkësitë fetare me 60 për qind dhe organizatat joqeveritare me 40 për qind besueshmëri. Sidoqoftë, është shqetësuese që perceptimet më negative të të anketuarve janë për mediat dhe partitë politike – rreth 23 për qind e të anketuarve u besojnë mediave dhe vetëm 12 për qind partive politike – duke u dëshmuar se janë institucionet më pak të besueshme në vitin 2022.

Sipas këndvështrimit të të anketuarve, siguria kombëtare e Kosovës sfidohet dukshëm nga krimi i organizuar dhe korrupsioni. 82 për qind përmendën krimin e organizuar dhe 80 për qind përmendën korrupsionin si dy fenomene që kërcënojnë sigurinë kombëtare dhe dëmtojnë sundimin e ligjit në Kosovë. Veç kësaj, të anketuarit nuk ishin të kënaqur as me performancën e Qeverisë së Kosovës në luftimin e korrupsionit apo krimin të organizuar, ndërsa vetëm 30 për qind e vlerësuan këtë të fundit si të mirë. Sidoqoftë, ka reagime pozitive në lidhje me raportimin e rasteve të korrupsionit, pasi 2/3 e të anketuarve – rreth 66 për qind – do ta raportonin tek institucionet përkatëse nëse do të ishin dëshmitarë të korrupsionit.

Bazuar në perceptimet e të anketuarve, praktikat e integritetit në administratën publike në Kosovë janë cenuar jashtëzakonisht shumë kur bëhet fjalë për punësimin në sektorin publik. Ka një shkallë të lartë skepticizmi marrë parasysh se 86 për qind e të anketuarve mendojnë se nëpunësit civilë në administratën publike janë të punësuar në bazë të nepotizmit (lidhjeve familjare), lidhjeve politike dhe ryshfetit ose korrupsionit, kundrejt vetëm 11 për qind që perceptojnë se janë të punësuar përmes sistemit të bazuar meritore dhe kualifikimeve. Të anketuarit priren të jenë më pak pesimistë në lidhje me proceset e rekrutimit në sektorin e sigurisë në krahasim me administratën publike, megjithatë sfidat mbeten. Rreth 42 për qind ndanë perceptimet se të punësuarit në institucione të sigurisë punësohen më shpesh bazuar në meritat dhe kualifikimet e kandidatëve, ndërsa rreth 54 për qind e të anketuarve mendojnë se janë të punësuar përmes nepotizmit, lidhjeve politike dhe ryshfetit apo korrupsionit.

HYRJE

Ky raport kuantitativ synon të interpretoj dhe të paraqes besimin që qytetarët e Kosovës kanë në institucionet shtetërore dhe joshtetërore, në mënyrë që të paraqiten perceptimet publike ndaj institucioneve me të cilat qytetarët apo të anketuarit kanë pasur ndërveprim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë brenda një periudhe 12-mujore. Përveç qëndrimeve të të anketuarve ndaj institucioneve në nivelin e besimit, perceptimet e të anketuarve tregojnë gjithashtu se sa transparente dhe llogaridhënëse janë institucionet përkatëse, si dhe po ashtu synojnë rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe qeverisjes së mirë nga pikëpamja institucionale.

Pjesa e parë e raportit zbërthen besimin e të anketuarve në institucionet shtetërore, ku përfshihen institucionet e sigurisë dhe drejtësisë, institucionet qendrore, lokale dhe të pavarura. Veç kësaj, kjo pjesë paraqet perceptimet ndaj institucioneve joshtetërore. Pjesa e dytë lidhet drejtpërdrejt me atë se çfarë mendojnë të anketuarit për përhapjen e gjerë të korrupsionit dhe krimit të organizuar në Kosovë si pengesat kryesore që dëmtojnë sundimin e ligjit në Kosovë. Ndërsa, pjesa e fundit përbëhet nga perceptimet në lidhje me mënyrën më të shpeshtë të punësimit të nëpunësve civilë dhe të punësuarve në administratën publike dhe sektorin e sigurisë. Mund të thuhet se ky raport synon kryesisht çështjet e integritetit me të cilat merren institucionet dhe sfidat që kërkojnë intervenime për përmirësimin e besueshmërisë së institucioneve shtetërore/joshtetërore dhe sundimit të ligjit, si dhe për forcimin e praktikave të integritetit të punësimit në sektorin publik.

Metodologjia

Të dhënat e anketës për këtë raport janë mbledhur në kuadër të anketës së Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP), përmes intervistave sy më sy me të anketuar të përzgjedhur rastësisht në mbarë Kosovën. BSBP është projekt rajonal i udhëhequr nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe anketa është kryer njëkohësisht në Shqipëri dhe Serbi. Për zbatimin e këtij projekti, QKSS-ja është në partneritet me Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) në Shqipëri dhe Qendrën e Beogradit për Politikën e Sigurisë (BCSP) në Serbi.

Hulumtimi në terren u realizua nga 25 shtatori deri më 2 tetor 2022. Pyetësi i anketës përbëhej kryesisht nga pyetje të mbyllura në formë të shkallës Likert me pesë pikë, të pasuara nga disa pyetje të hapura pa opsione të paracaktuara. Mostra kombëtare për anketën përfshinte 1,136 amvisëri.

Faza e parë e tërheqjes së mostrës u bazua në njësitë administrative të Drejtorive Rajonale të Policisë së Kosovës, duke përfshirë tetë rajonet e mëposhtme: Ferizaj, Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë – Jug, Mitrovicë – Veri, Pejë, Prishtinë dhe Prizren. Numri i anketimeve të kryera në secilin rajon u përcaktua në përpjesëtim me numrin e popullatës për secilën komunë brenda rajoneve përkatëse bazuar në regjistrimin e popullsisë në Kosovë të vitit 2011. Brenda komunave, mostra u shtresua në mostër urbane/rurale bazuar në numrin e amvisërive në secilën zonë.

Për përzgjedhjen e amvisërive brenda lokaliteteve të mostruara u përdorën modele të rastësishme, ndërsa rastësia brenda amvisërive u bazua në metodën e ditëlindjes së radhës të një anëtari të rritur. Të dhënat u verifikuan në kohë reale përmes koordinatoreve në terren që vizituan një mostër të paracaktuar të amvisërive pas përfundimit të studimit në amvisëritë përkatëse, përmes kontaktit telefonik me të gjithë të anketuarit, për të konfirmuar respektimin e metodologjisë dhe disa nga përgjigjet kyçe, si dhe duke analizuar konsistencën logjike të përgjigjeve gjatë përpunimit dhe analizimit të të dhënave. Marzha i gabimit është 3 për qind me një interval besueshmërie prej 95 për qind.

1. BESIMI I PUBLIKUT NË INSTITUCIONET SHETËRORE DHE JOSHTËRORE TË KOSOVËS

Ky kapitull përbëhet nga dy pjesë kyçe mbi besimin e të anketuarve kosovarë në institucionet shtetërore dhe joshtetërore në Kosovë dhe që ofrojnë interpretimin e të dhënave mbi perceptimet e të anketuarve sipas nivelit të caktuar të besueshmërisë.

Pjesa e parë e kapitullit tregon rezultatet e anketës së BSBP-së për besimin në institucionet e mëposhtme shtetërore:

Institucionet e sigurisë: Forca e Sigurisë së Kosovës, Policia e Kosovës, Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave, Inspektorati Policor i Kosovës, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë dhe Dogana e Kosovës.

Institucionet e drejtësisë: Gjykatat dhe Prokuroria.

Institucionet qendrore dhe lokale: Kuvendi i Kosovës, Presidentja, Qeveria dhe Komunitat.

Agjencitë e pavarura shtetërore: Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Zyra Kombëtare e Auditimit.

Pjesa e dytë mat besimin e të anketuarve në institucionet joshtetërore të cilat kanë ndikim në sferën publike si më poshtë:

Institucionet joshtetërore: Bashkësitë fetare, partitë politike, organizatat joqeveritare dhe mediat.

1.1. Besimi në institucionet shtetërore

Ngjashëm me anketat e mëparshme të kryera në kuadër të BSBP-së, institucionet e sigurisë në Kosovë janë identifikuar si institucionet më të besueshme nga të anketuarit në Kosovë. Forca e Sigurisë së Kosovës është renditur si institucioni më i besueshëm jo vetëm në sektorin e sigurisë, por edhe në krahasim me institucionet në kuadër të sektorëve të tjerë. Kështu, 83 për qind e të anketuarve kanë besim apo besim të plotë në Forcën e Sigurisë së Kosovës në krahasim me 9 për qind që kanë pak besim ose aspak besim në këtë institucion të uniformuar. Forca e Sigurisë së Kosovës e ka ruajtur këtë nivel të lartë besimi për disa vite edhe pse ndërveprimi i saj me qytetarët është më i rrallë në krahasim me institucionet e tjera.¹ Institucioni tjetër që gëzon nivel të lartë besimi është Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave me 73% të të anketuarve që kanë besim ose besim të plotë. Vlen të theksohet se besimi në këtë mekanizëm emergjent (i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme) është më tepër i lidhur me Departamentin e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit i cili përgjigjet në rastet e emergjencave. Policia

e Kosovës është renditur në vendin e tretë në mesin e institucioneve të perceptuara më pozitivisht nga të anketuarit, me 72 për qind që shprehin besim apo besim të plotë në Policinë e Kosovës, krahasuar me 11 për qind të të anketuarve që nuk kanë besim në Policinë e Kosovës në vitin 2022. Kjo mund t'u atribuohet kontakteve të shpeshta të qytetarëve me Policinë e Kosovës, duke qenë ndër institucionet e para që i adresojnë shqetësimet e tyre.² Inspektorati Policor i Kosovës, roli i të cilit është të hetojë dhe të shërbejë si mbikëqyrës i policisë, ka shënuar rritje të konsiderueshme të besimit nga të anketuarit në krahasim me vitet e kaluara. Për shembull, në vitin 2020³ rreth 49 për qind e të anketuarve ishin shprehur se i besojnë Inspektoratit Policor⁴, kurse në vitin 2022, 60 për qind e të anketuarve në Kosovë janë përgjigjur se kanë besim apo besim të plotë në Inspektoratin Policor të Kosovës. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë është institucioni tjetër ndaj të cilit është rritur besimi i publikut në vitin 2022 – nga 45 për qind besueshmëri në vitin 2021⁵ në 51 për qind më 2022. Agjencia për Inteligjencë me sa duket është perceptuar pozitivisht nga të anketuarit për shkak të aktiviteteve të saj të koordinuara me Policinë e Kosovës dhe shtetet aleate të Kosovës në aspektin e sigurisë kombëtare, veçanërisht në veri të Kosovës duke shmangur disa kërcënime nga ndikimi rus pas pushtimit të paprovokuar ushtarak të Rusisë kundër Ukrainës.⁶ Sa i përket Doganës së Kosovës, rreth 46 për qind e të anketuarve kanë besim në këtë institucion, duke treguar një rritje të lehtë për 1 për qind në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021⁷.

Sidoqoftë, në pyetjen se si i perceptojnë institucionet e drejtësisë, të anketuarit janë mjaft skeptikë për punën e Gjykatave dhe Prokurorisë së Kosovës. Të dy institucionet përballen me sfida sipas të anketuarve dhe përqindja e të anketuarve që kanë besim në sektorin e drejtësisë është dukshëm më e ulët në krahasim me institucionet e sigurisë. Kështu, 30 për qind e të anketuarve treguan besim ose besim të plotë në Gjykata dhe Prokurori, që është i njëjti nivel besimi i shprehur në vitin 2021.⁸ Për më tepër, rreth 40 për qind e të anketuarve nuk kanë besim ose kanë pak besim në Prokurori dhe 38 për qind të tjerë kanë pak besim ose nuk kanë aspak besim në Gjykata.

Sa u përket institucioneve qendrore të Kosovës, përveç Presidentes, për të cilën rezultatet e anketës tregojnë një rritje të besimit të të anketuarve nga 56 për qind në vitin 2021 në 59 për qind në vitin 2022, besimi i publikut në Kuvend ka rënë dukshëm në vitin 2022 në krahasim me vitin paraprak (2021). Vetëm 25 për qind e të anketuarve kanë besim tek Kuvendi, krahasuar me 33 për qind në vitin 2021.⁹ Ky është një nga treguesit se legjislatura e Kosovës po përballlet me sfida sa i përket besimit të publikut në këtë institucion, pasi 47 për qind e të anketuarve deklaruan se nuk kanë besim në të. Gjithashtu ka një rënie të lehtë të besimit në Qeverinë e Kosovës, pasi që 34 për qind e të anketuarve kanë shprehur besim në vitin 2022 krahasuar me 36 për qind në vitin 2021 që kishin besim në pushtetin ekzekutiv. Ndryshe nga institucionet qendrore, besimi i publikut në institucionet lokale, veçanërisht në komuna, është rritur në vitin 2022. Teksa në vitin 2021, rreth 51 për qind e të anketuarve kishin besim tek komunat, në vitin 2022 komunat fituan një rritje prej katër për qind me 55 për qind të të anketuarve gjithsej që u përgjigjën se kanë besim në institucionet komunale.

Krahas institucioneve të lartpërmendura, përmes anketës së BSBP, QKSS-ja ka matur edhe perceptimet ndaj dy agjencive të pavarura të Kosovës: Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Zyra Kombëtare e Auditimit. Në këtë drejtim, tek Avokati i Popullit të Kosovës kanë besim 43 për qind e të anketuarve dhe rreth 22 për qind e tyre kanë pak besim ose aspak besim. Sidoqoftë, Zyra Kombëtare e Auditimit ka besueshmërinë më të ulët

duke qenë se 37 për qind e të anketuarve janë përgjigjur se kanë besim apo besim të plotë në këtë agjenci të pavarur që auditon shpenzimet e financave publike. Për më tepër, qytetarët e Kosovës kanë pak informata ose nuk janë të njohur me misionin dhe mandatin e Zyrës Kombëtare të Auditimit¹⁰ duke qenë se 10 për qind e të anketuarve nuk dinë / nuk kanë opinion kur pyeten për perceptimet e tyre.

FIGURA 1 BESIMI NË INSTITUCIONET E SIGURISË



FORÇA E SIGURISË SË KOSOVËS



INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS



AGJENCIA E MENAXHIMIT TË EMERGJENCEVE



AGJENCIA E KOSOVËS PËR INTELIGJENCË



POLICIA E KOSOVËS



DOGANA E KOSOVËS



FIGURA 2 BESIMI NË INSTITUCIONET E DREJTËSISË




FIGURA 3 BESIMI NË INSTITUCIONET E NIVELIT QENDROR DHE LOKAL




FIGURA 4 BESIMI NË AGJENCITË E PAVARURA SHTETËRORE


1.2. Besimi në institucionet joshtetërore

QKSS-ja ka matur edhe perceptimet e të anketuarve ndaj disa prej institucioneve dhe organeve joshtetërore me të cilat ata kanë ndërveprim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Ka rezultuar se bashkësitë fetare në Kosovë kanë perceptimet më të larta pozitive, pasi që 60 për qind e të anketuarve kanë besim në to. Sidoqoftë, rreth 18 për qind e të anketuarve janë përgjigjur se nuk kanë besim ose kanë pak besim, ndërsa 21 për qind të tjerë kanë besim deri diku në bashkësitë fetare të Kosovës. Pas tyre vijnë organizatat joqeveritare – duke përfshirë këtu organizatat e shoqërisë civile, qendrat studimore, institutet hulumtuese etj. – të cilat gëzojnë besimin e 40 për qind të të anketuarve. Për më tepër, rreth 32 për qind kanë besim deri diku në organizatat joqeveritare dhe 24 për qind të tjerë kanë pak besim ose nuk kanë aspak besim.


Të dhënat e anketës së BSBP-së tregojnë se mediat dhe partitë politike janë institucionet më pak të besueshme në Kosovë, jo vetëm brenda institucioneve joshtetërore, por edhe në krahasim me institucionet shtetërore. Kështu, vetëm 23 për qind e të anketuarve kanë besim ose besim të plotë në mediat e Kosovës dhe 47 për qind nuk kanë besim ose kanë pak besim në mediat kryesore (p.sh. kanalet televizive) dhe mediat online që operojnë në Kosovë. Ky është një ndryshim domethënës për shkak se në vitin 2021 rreth 28 për qind e qytetarëve u besonin mediave dhe 40 për qind e tyre nuk kishin besim,¹¹ dhe tregon rënie prej 5 për qind në besimin e të anketuarve në media në vitin 2022. Nga ana tjetër, partitë politike perceptohen kryesisht negativisht dhe në përqindje më të ulët se mediat për sa i përket besimit. Jo më shumë se 12 për qind e të anketuarve u besojnë partive politike ekzistuese të Kosovës. Numri i të anketuarve që nuk u besojnë partive politike është i lartë, ku 60 për qind kanë pak ose aspak besim, dhe 27 për qind e të anketuarve kanë besim deri diku. Anketa e BSBP-së nuk u ka kërkuar të anketuarve që t'i tregojnë në mënyrë specifike perceptimet për partitë politike veç e veç dhe në vend të kësaj, kjo pyetje ka qenë në përgjithësi për partitë politike në Kosovë në tërësi.

FIGURA 5 BESIMI NË INSTITUCIONET JOSHTETËRORE


BASHKËSITË FETARE NË KOSOVË




ORGANIZATAT JOQEVERITARE



MEDIAT



PARTITË POLITIKE



2. PERCEPTIMET E TË ANKETUARVE PËR KORRUPSIONIN NË KOSOVË

Edhe në këtë anketë të vitit 2022 ka vazhduar trendi i perceptimit të aktiviteteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit si një nga kërcënimet më të larta ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës. Në këtë kontekst, bazuar në përgjigjet e anketës, krimi i organizuar po e dëmton sundimin e ligjit brenda vendit. Trafiku i drogës është i pari në listën që kërcënon sigurinë kombëtare kur bëhet fjalë për rreziqet e krimit të organizuar. Kështu, 86 për qind e të anketuarve ndanë pikëpamjet e tyre se trafiku i drogës është kërcënim apo kërcënim i lartë për sigurinë kombëtare, i ndjekur nga vetë krimi i organizuar me 82 për qind që e perceptojnë si kërcënim. Për më tepër, më shumë se 80 për qind e të anketuarve mendojnë se korrupsioni është kërcënim apo kërcënim i lartë, i ndjekur nga trafiku i armëve, ku 77 për qind e të anketuarve e perceptojnë si kërcënim për sigurinë kombëtare.

Kjo anketë kishte dy pyetje që pyesnin të anketuarit nëse do ta raportonin korrupsionin po të ishin dëshmitarë të këtij fenomeni – pyetja e parë ishte e mbyllur dhe e dyta ishte e hapur, për t'i matur saktësisht perceptimet kur bëhet fjalë për raportimin e korrupsionit. Është shumë pozitive që rreth dy të tretat e të anketuarve në të dyja pyetjet do të ishin të gatshëm ta raportonin korrupsionin në institucionet përkatëse. Në rastin e pyetjes së mbyllur, 64 për qind e të anketuarve do ta raportonin korrupsionin tek institucionet shtetërore krahasuar me 24 për qind që nuk do ta raportonin për shkak të perceptimit se asgjë nuk do të ndryshonte ose se institucionet nuk do të reagonin, ndërsa 11 për qind të tjerë do të hezitonin për shkak të mundësive për t'u përballur me pasoja negative, si hakmarrja, diskriminimi, largimi nga puna, arrestimi, etj. Kur bëhet fjalë për pyetjen e dytë të hapur, të anketuarve iu kërkua të përmendnin një institucion të cilit do t'i besonin më shumë për ta raportuar korrupsionin. Rrjedhimisht, 67 për qind e tyre kanë renditur Policinë e Kosovës si institucioni ku do ta raportonin më parë korrupsionin. Institucionet e tjera, si Gjykatat, Prokuroria, etj., renditen në përqindje shumë të papërfillshme, çka reflektohet drejtpërdrejt/tërthorazi në besimin e publikut në to.

Përkundër këtyre rezultateve, është alarmante për institucionet përkatëse shtetërore në Kosovë që shumica dërrmuese e të anketuarve, 81 për qind, nuk kanë dijeni se ekziston Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Kosovë. Veç kësaj, vetëm 15 për qind kanë dijeni rreth këtij ligji dhe 4 për qind të tjerë nuk kanë asnjë opinion për këtë çështje. Vlen të theksohet se Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve ka hyrë në fuqi në fund të vitit 2018.

FIGURA 6 KORRUPSIONI DHE KRIMI I ORGANIZUAR NDËR KËRCËNIMET KRYESORE NDAJ SIGURISË KOMBËTARE






FIGURA 7 RAPORTIMI I KORRUPSIONIT


NËSE DO TË ISHA DËSHMITAR I KORRUPSIONIT:



A MUND TE PËRMENDNI NJË INSTITUCION QË DO TË KISHIT MË SË SHUMTI BESIM TA RAPORTONIT KORRUPSIONIN (PYETJE E HAPUR)?



A JENI NË DIJENI PËR LIGJIN PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE NË KOSOVË?



Të anketuarit shprehën mjaft dyshime kur iu kërkua të vlerësojnë aktivitetet e Qeverisë së Kosovës në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Pyetja ishte të vlerësohej vullneti politik i pushtetit ekzekutiv për t'i udhëhequr reformat në pushtetin gjyqësor dhe jo të vlerësohej në pikëpamje praktike reagimi i Qeverisë në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, duke qenë se kjo është kompetencë specifike e mekanizmave të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit. Kështu, ka rezultuar se rreth 30 për qind e të anketuarve e kanë vlerësuar si të mirë luftën kundër korrupsionit dhe 28 për qind të tjerë e kanë vlerësuar si të mirë luftën kundër krimin të organizuar. Ndërsa, është një numër solid i të anketuarve që e vlerësojnë punën e Qeverisë së Kosovës si deri diku të mirë në këtë drejtim – 36 për qind në luftën kundër korrupsionit dhe 38 për qind në luftën kundër krimin të organizuar. Sidoqoftë, rreth 33 për qind e të anketuarve i shihnin si të dobëta aktivitetet e Qeverisë në të dy këta sektorë.


Të anketuarit ndanë perceptime të ngjashme në lidhje me vlerësimin e përpjekjeve të Qeverisë në luftën kundër korrupsionit përgjatë 12 muajve të fundit. 24 për qind e të anketuarve shohin përmirësime të dukshme ose domethënëse në këtë drejtim. Përkundrazi, 37 për qind e të anketuarve perceptojnë se ka pasur një përmirësim të vogël dhe 29 për qind të tjerë i shohin si regresive përpjekjet e Qeverisë në 12 muajt e fundit pasi situata mbetet e njëjtë. Për më tepër, rreth 8 për qind mendojnë se situata është përkeqësuar dhe rënduar në 12 muajt e fundit për faktin se tani ka më shumë korrupsion se më parë.

FIGURA 8 LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

SI E VLERËSONI PUNËN E QEVERISË SË KOSOVËS NË FUSHAT E PËRMENDURA MË POSHTË?



SI I VLERËSONI PËRPJEKJET E QEVERISË SË KOSOVËS NË LUFTIMIN E KORRUPSIONIT GJATË 12 MUAJVE TË FUNDIT?



3. INTEGRITETI I PROCESIT TË REKRUTIMIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE TË KOSOVËS



Integriteti i administratës publike të Kosovës është i një rëndësie jetike dhe duke e ditur se administrata publike është e integruar në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, QKSS-ja ka matur perceptimin e publikut se si e shohin të anketuarit procesin e rekrutimit të kryer nga institucionet publike.

Është jashtëzakonisht shqetësues fakti që 86 për qind e të anketuarve mendojnë se nëpunësit civilë në administratën publike nuk punësohen në bazë të meritave dhe kualifikimeve të tyre. Nëse interpretohen rezultatet për përgjigjet e dhëna nga të anketuarit përmes opsioneve të paracaktuara, rreth 44 për qind e tyre vendosin nepotizmin (lidhjet familjare) në vend të parë si formën më të shpeshtë se si punësohen nëpunësit civilë, 32 për qind i perceptojnë lidhjet politike dhe 10 për qind perceptojnë rryshfetin ose korrupsionin si të tretën. Ndërkohë, vetëm 11 për qind e të anketuarve perceptojnë se nëpunësit civilë në administratën publike punësohen përmes një procesi të rregullt punësimi merit bazuar në kualifikime.

Kur flitet për procesin e rekrutimit në kuadër të sektorit të sigurisë, perceptimet e të anketuarve janë më pak negative në krahasim me administratën publike në përgjithësi, megjithatë ky proces i sfiduar seriozisht sipas të anketuarve. Për më tepër, 42 për qind ndanë perceptimet se të punësuarit e institucioneve të sigurisë janë më shpesh të punësuar në përputhje me proceset e rregullta të punësimi merit bazuar në kualifikime. Ndryshe prej tyre, rreth 54 për qind e tyre perceptojnë se të punësuarit e sektorit të sigurisë në Kosovë punësohen përmes procedurave joformale, si nepotizmi (lidhjet familjare) me 26 për qind, lidhjet politike me 22 për qind dhe rryshfeti dhe korrupsioni me 6 për qind, siç tregohet në figurat e mëposhtme.

Të anketuarit nuk ishin optimistë kur u është kërkuar të vlerësojnë punën e Qeverisë së Kosovës në luftimin e nepotizmit dhe sigurimin e mundësive të barabarta në punësim. Vetëm 21 për qind e të anketuarve e vlerësuan si të mirë performancën e Qeverisë në luftimin e nepotizmit dhe garantimin e mundësive të barabarta në punësim, krahasuar me 40 për qind të të anketuarve që e perceptojnë si të dobët. 35 për qind të tjerë e konsiderojnë deri diku të mirë punën e Qeverisë në këtë drejtim.

FIGURA 9 PERCEPTIMET E TË ANKETUARVE PËR PROCESIN E PUNËSIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE DHE TË SIGURISË



SI E VLERËSONI PUNËN E QEVERISË SË KOSOVËS NË LUFTIMIN E NEPOTIZMIT DHE GARANTIMIN E TË DREJTAVE TË BARABARTA NË PUNËSIM?



REFERENCAT

1. Balaj, S. (2022). Perceptimet e qytetarëve për integritetin e institucioneve publike në Kosovë. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, f. 3. Gjetet në: https://qkss.org/images/uploads/files/Barometer_2021_Kosovo_1_SHQP.pdf
2. Diskutime në grupin e fokusit me përfaqësues të institucioneve publike të Kosovës, 11 nëntor 2022.
3. Balaj, S. (2020). Besimi i qytetarëve të Kosovës ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, f. 7. Gjetet në: https://qkss.org/images/uploads/files/WBSB_KosovoReport_Alb_final_988743.pdf
4. Nuk ka të dhëna lidhur për vitin 2021 për besimin e të anketuarve në Inspektoratin Policor të Kosovës.
5. Balaj, S. (2022). Perceptimet e qytetarëve për integritetin e institucioneve publike në Kosovë. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, f. 4. Gjetet në: https://qkss.org/images/uploads/files/Barometer_2021_Kosovo_1_SHQP.pdf
6. Diskutime në grupin e fokusit me përfaqësues të institucioneve publike të Kosovës, 11 nëntor 2022.
7. Balaj, S. (2022). Perceptimet e qytetarëve për integritetin e institucioneve publike në Kosovë. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, f. 4. Gjetet në: https://qkss.org/images/uploads/files/WBSB_KosovoReport_Alb_final_988743.pdf
8. Po aty, f. 5.
9. Po aty.
10. Diskutime në grupin e fokusit me hulumtuesit e terrenit që realizuan anketën e BSBP-së, 12-13 tetor 2022.
11. Balaj, S., & Perteshi, S. (2022). Ndikimi i dezinformimit dhe polarizimit politik gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, f. 31. Gjetet në: https://qkss.org/images/uploads/files/WHEN_THE_MASKS_CAME_OFF_Shqip.pdf

Katalogimi në botim **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës - "Pjetër Bogdani"

35(496.51)

303.425.6(496.51)(047)"2022"

Avdiu, Plator


Perceptimet publike për besimin, korrupsionin dhe integritetin e institucioneve publike në Kosovë / Plator Avdiu. - Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2022. - 16 f. : ilustr. ; 24 cm.

Administrata shtetërore -- Administrata civile -- Korrupsioni -- Kosovë

Testet e opinionit publik -- Raporte -- Kosovë -- 2022

ISBN 978-9951-799-71-3

Aleph [000105337]



ISBN 978-9951-799-71-3



9 789951 799713